



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

URDHËR

Nr. 777, datë 28/04/2015

PËR “MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË AUTORITETIT TË
KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE”

Në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7, 19 të ligjit nr. 119 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” (LDI) dhe pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit të Transparencës së Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bashkangjitur këtij urdhëri.
2. Përditësimin e Programit të Transparencës, në përputhje me nenin 4 dhe pikën 2 të nenit 19 të LDI-së, me qëllim:
 - a. garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
 - b. vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion.
 - c. modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Drejtave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.
3. Publikimin e Programit të Transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve www.akshe.gov.al në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” dhe në mjediset e pritjes së publikut.
4. Delegimi i kompetencave të parashikuara në pikën 2 neni 19 të LDI-së Drejtorisë së Inspektimit Vlerësimit dhe Analizës, si më poshtë vijon:
 - a. Zbatimin e Programit të Transparencës së miratuar, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.
 - b. Rishikimin e Programit të Transparencës një herë në 4 vjet, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së, përmes të njëjtës procedurë që është bërë dhe miratimi i tij.
 - c. Dhënin e informacionit në rrugë shkresore ose në rrugë elektronike pa pagesë:

- Në rastet kur vlerësohet se dhënia e informacionit do kryhet kundrejt pagesës, tarifa do përcaktohet më parë dhe do bëhet publike nga AKSHE në faqen e saj të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe kur është rasti dhe dërgimit të tij.
- Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni. Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria e Inspektimit Vlerësimit dhe Analizës.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Engjëllush BEKTESHI

